GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe mr.sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve P.G., D.P., S.S. dhe B.K., të gjithë nga Shtërpca, të cilët i përfaqëson me autorizim av.A.I., nga Prishtina, kundër të paditurës K.S''I'' me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim I.H., për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, përkitazi me revizionin e paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.2379/2014, datë 04.11.2015, në seancën e mbajtur më 10.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT pranohet revizioni i paditësve dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr2379/2014, datë 04.11.2015, dhe ai i Gjykatës Themelore Ferizaj -Dega në Shtërpce, C.nr.52/2010, datë 29.10.2013, për sa i përket shpërblimit të dëmit jomaterial, ashtu që, në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, paditësit D.P. i caktohet shuma prej 15.120,00 €, kurse paditësit S.S, po ashtu në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, i caktohet shuma prej 13.500 €.

II. Në pjesën tjetër, revizioni i paditësve dhe ai i të paditurës refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj - Dega në Shtërpce, C.nr.52/2010, datë 29.10.2013, është aprovuar kërkesëpadia e paditësve dhe është obliguar e paditura që atyre, në emër të shpërblimit të dëmit, të cilin e kanë pësuar në aksidentin e trafikut shkaktuar më 25.9.2010 nga automjeti transportues – kamioneta ... me targa ..., të cilën e drejtonte B.I, t'ua paguajë shumat si më poshtë:

1. Paditësit P.G.,

-në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 6.000 €,

-në emër të frikës së pësuar, shumën prej 4.000 € dhe

-në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 3,500 €,

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 12.000 €,

-për kujdesin e huaj, shumën prej 300 €,

-për ushqim të përforcuar, shumën prej 400 €,

-në emër të zvogëlimit të aftësisë për punë me 45%, rentën mujore për fitimin e humbur për periudhën prej 25.9.2010 gjer më 31.5.2012, në shumën prej 2.424,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 28.624 €, me kamatë sipas normës që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data 14.5.2012 (kur është bërë ekspertiza nga eksperti i mjekësisë), gjer te pagesa përfundimtare. E paditura duhet që paditësit P.G., në emër të rentës mujore për fitimin e humbur dhe atë prej 01.6.2012 gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore, t'ia paguajë në të ardhmen shumën mujore prej nga 120 € për muajin e ardhshëm, më së voni gjer në datën 10 të muajit.

2. Paditësit D.P.,:

- në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 5.000 €,

-në emër të frikës së pësuar, shumën prej 4.000 €,

-në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 3.500 €,

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 21.600 €,

-për kujdesin e huaj, shumën prej 400 €,

-për ushqim të përforcuar, shumën prej 500 €,

-në emër të zvogëlimit të aftësisë për punë me 65%, rentën mujore për fitimin e humbur për periudhën prej 25.9.2010 gjer më 31.5.2012, shumën prej 3.577€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 38.577 €, me kamatë sipas normës që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data 14.5.2012 (kur është bërë ekspertiza nga eksperti i mjekësisë) gjer te pagesa përfundimtare. E paditura duhet që paditësit D.P., në emër të rentës mujore për fitimin e humbur dhe atë prej 01.6.2012 gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore, t'ia paguajë në të ardhmen shumën mujore prej nga 117.10 € për muajin e ardhshëm, më së voni gjer në datën 10 të muajit.

3. Paditësit S.S.:

-në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 6.000 €,

-në emër të frikës së pësuar, shumën prej 3.000 €,

-në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 3.500 €,

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 22.500 €,

-për kujdesin e huaj, shumën prej 400 €,

-për ushqim të përforcuar, shumën prej 600 €,

-në emër të zvogëlimit të aftësisë për punë me 55%, rentën mujore për fitimin e humbur për periodën prej 25.9.2010 gjer më 31.5.2012, shumën prej 39.017€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 39.017€, me kamatë sipas normës që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data 14.5.2012 (kur është bërë ekspertiza nga eksperti i mjekësisë) gjer në pagesën përfundimtare. E paditura duhet që paditësit S.S., në emër të rentës mujore për fitimin e humbur dhe atë prej 01.6.2012 gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore, t'ia paguajë në të ardhmen shumën mujore prej nga 149.40 € për muajin e ardhshëm, më së voni gjer në datën 10 të muajit.

4.Paditësit B.K.,

- në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin e tij të markës "..." me tabela regjistrimi ... shumën prej 1.510 €, me kamatë sipas normës që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data 27.4.2012, kur është bërë ekspertimi i automjetit të dëmtuar, gjer te pagesa përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 3.828 €, në afat prej 15 ditësh nga dita që ky aktgjykim] të ketë marrë formë të prerë.

Me rastin e ankesës së të padituës, Gjykata e Apelit të Kosovës e ka aprovuar pjesërisht atë, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj - Dega në Shtërpcë, në par.I të dispozitivit, për sa u përket paditësve P.G., D.P. dhe S.S., e ka ndryshuar, duke ua caktuar shumat si më poshtë dhe pikërisht:

Paditësit D.G.,

-në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 4.500 €,

-në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3.500 € dhe

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shumën prej 9.000 €

Paditësit D.P.,

-në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 4.000 €

-në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3.000 € dhe

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shumën prej 15.000 €;

Paditësit S.S.,

-në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 4.500 €,

-në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 2.500 € dhe

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 12.500 €.

Në pjesën tjetër ankese e të autorizuarit të së padituës është refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion të paditësit në kuptim të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimroe dhe konstatoi:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në aksidentin e trafikut që është shkaktuar më 25.9.2010 në Shtërpcë nga drejtuesi i automjetit "... me targa ..., drejtuar nga B.I., i cili, duke kaluar në anën e majtë të rrugës, e godet automjetin WV Golf me targa ..., të cilin e drejtonte paditësi S.S., por që ishte pronë e P.G., dhe në të cilin ndodheshin si bashkudhëtarë D.P. dhe S.S. Në këtë aksident paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Lidhur me intensitetin e dhimbjeve fizike, të frikës, me shkallën e shëmtimit trupor, të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, zvogëlimit të aftësisë për punë, kohëzgjatjen e ndihmës së huaj dhe ushqimin e përforcuar për paditësit, janë deklaruar ekspertët: dr. Xh.S., ortoped traumatolog dhe N.M., psikiatër.

Nga raporti i ekspertëve të përmendur më sipër rezulton se paditësi P.G., në këtë aksident kishte pësuar lëndime të rënda trupore, duke përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 2 orësh, të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 5 ditësh dhe të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 42 ditësh, ndërsa dhimbje fizike të intensitetit të ulët përjeton edhe sot e kësaj dite. Ky paditës ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda,

ndërsa frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 5 ditë, e intensitetit të ulët 12 muaj; shëmtimi trupor që ka pësuar ai është në shkallë të mesme, që manifestohet me vraja prej 5 cm mbi hundë, kurse në regjionin ballor 27 cm. Zvogëlim i aktivitetit jetësor të tij është 30 %, ndërsa ndihma huaj ka qenë nevojshme 3 muaj, ushqimi i përforcuar 4 muaj, për rehabilitim ka pasur nevojë 30 ditë në vitin e parë dhe 30 ditë në vitin e dytë. Zvogëlimi i aftësisë për punë është në shkallën 45 %.

Paditësi D.P. ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat ishin manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë, që kanë zgjatur disa sekonda, intensitetit të lartë 5 ditë, të intensitetit të mesëm 42 ditë, kurse dhimbje të intensitetit të ulët përjeton edhe sot e kësaj dite. Frika primare ka zgjatur disa sekonda, ndërsa frika sekondare e intensitetit të lartë 5 ditë, ajo e intensitetit të ulët 12 muaj. Shëmtimi është i shkallës së mesme, ndërsa zvogëlimi i aktivitetit jetësor është 54%. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 4 muaj, ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej 5 muaj, kurse rehabilitimi në vitin e parë ishte i nevojshëm 30 ditë dhe në vitin e dytë, po ashtu, 30 ditë. Aftësia e punues e këtij paditësi është zvogëluar në shkallën 65 %.

Paditësi S.S. ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat janë manifestuar me dhimbje fizike të intensiteti posaçërisht të lartë prej 2 orë, të intensitetit të lartë prej 5 ditë, të intensitetit të mesëm prej 42 ditë, kurse dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite. Ky paditës ka pësuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda, ndërsa frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 5 ditë dhe e intensitetit të ulët 6 muaj. Shëmtimi trupor është i shkallës së mesme, ndërsa aktiviteti i përgjithshëm jetësor i është ulur në shkallën 45 %. Ndërkaq, ndihma dhe kujdesi i huaj ka qenë i nevojshëm 4 muaj, ushqim i përforcuar 6 muaj, kurse për rehabilitim ka pasur nevojë 2 vite nga 30 ditë. Aftësia e punës e paditësit në fjalë është ulur në shkallën 55 %.

Për dëmtimet e automjetit të paditësit B.K. vlerësimin e ka bërë ing.R.Sh., sipas të cilit, vlera e dëmit të shkaktuar në automjetin “WW Golf 10E” me tabela regjistrimit ... kap një shumë prej 1.510,20.

Eksperti aktuar ka konstatuar në raportin e tij me shkrim se paditësi S.S. aktualisht është pa punë dhe se më parë ka punuar si automekanik në ... prej 02.08.2001 deri në 09.12.2010, kurse është pushuar nga puna për shkak të aksidentit. Ai ka realizuar pagën mesatare bruto prej

295,50 € në muaj, ndërsa paga neto do të ishte 271,67 €, ndërsa për 55% të zvogëlimit të aftësisë për punë paga do të ishte 149,40 €. Renta për periudhën prej 25.09.2012, (kur ka ndodhur aksidenti), gjer më 31.05.2012, do të ishte 3.017,86 €, ndërsa në të ardhmen renta mujore kap një shumë prej 149.40 €.

Për paditësin P.G., për periudhën e kaluar renta do të ishte 2.424,00 €, pasi që ai ka punuar si automekanik në ... me kontratë, ndërsa në të ardhmen shuma mujore e rentës do të ishte 120 €. Paditësit D.P., sipas ekspertit në fjalë, për periudhën e kaluar i takon, në emër të fitimit të humbur, shuma prej 3.577,42 €, ndërsa në të ardhmen renta mujore duhet të jetë 117,10 €.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, e ka obliguar të padituren që paditësve, në emër të dëmit jomaterial dhe atij material, t'ua paguajë shumat e caktuara në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, duke pranuar pjesërisht ankesën e të padituës, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke ua caktuar shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shumat e caktuara nga ana e gjykatës së instancës më të ulët, që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial në emër të uljes së aktivitetit të përgjithshëm jetësor për paditësit D.P. dhe S.S., nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jomaterial, duke marrë parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës sël dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim, siç parashikohet me nenin 200 par.1 dhe 2 të Ligjit të Detyrimeve. Kjo Gjykatë, duke pranuar pjesërisht revizionin e paditësve, e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë, ashtu që, në emër të dëmit jomaterial për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, paditësit D.P. ia caktoi shumën prej 15.120,00 €, ndërsa paditësit S. shumën prej 13.500 €. Nisur nga kjo gjendje e çështjes e duke pasur parasysh moshën e paditësve në kohën e pësimit të aksidentit, natyrën e lëndimeve si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jomaterial, kjo Gjykatë konsideron se te shumat e caktuara paditësit mund të gjejnë një satisfaksion të konsiderueshëm për dhimbje shpirtërore të përjetuara për shkak të uljes së aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Nuk qëndrojnë thëniet e ngritura në revizion se shumat e caktuara për dhimbjet fizike, frikën, shëmtimin trupor të paditësve janë të ulëta, ngaqë gjykata e shkallës së dytë e ka

arsyetuar vendimin e saj për pranimin e këtyre shumave, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, intensitetin e dhimbjeve fizike e të frikës dhe shkallën e shëmtimit, prandaj nuk qëndrojnë thëniet e paditësve se gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh, me rastin e caktimit të shumave në emër të dëmit jomaterial, natyrën e lëndimeve, intensitetin e dhimbjeve e të frikës dhe as shkallën e shëmtimit të tyre. Shumat e caktuara për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar për paditësit paraqesin satisfaksion të plotë në kuptim të nenit 200 par.1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve dhe janë në harmoni me standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe me praktikën e gjertanishme të gjykatave tona. Shumat e caktuara janë në përputhje me kriteret e parashikuara në këtë dispozitë ligjore, për të cilën arsye aktgjykimi i shkallës së dytë u vërtetua.

Për arsyet e mësipërme dhe në kuptim të nenit 224.1 të LPK, u vendos si në pikën I, kurse në kuptim të nenit 222 të LPK, u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.28/2016, datë 09.09.2015

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri